



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 163

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA E  
MAQEDONASVE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN”, ME KRYETAR Z. VASIL  
STERJOVSKI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET  
PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1211 Prot., datë 21.2.2025, me:

**KËRKUES:** Partia politike Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, me kryetar Z. Vasil Sterjovski

**OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

**BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Data: 25.2.2025 Nr: 163  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, me Kryetar Z. Vasil Sterjovski, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Vasil Sterjovski, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 21.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, me iniciale “A.M.I.E”, me Kryetar Z. Vasil Sterjovski, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është: Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European” me shkronja nistore “A.M.I.E”, me adresë: Fshati Pustec, Bashkia Pustec;
- b) Kryetari i partisë është Z.Vasil Sterjovski, me adresë: Fshati Gorna Gorica, Bashkia Pustec;
- c) Financieri i partisë është Z. Atanas Plloça, me adresë: Fshati Cerje, Bashkia Pustec;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Endrit Fetahu, me adresë: Rruga “Mihail Ciko”, pranë mozaikut, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, me kryetar Z. Vasil Sterjovski, me shkronjat nistore “A.M.I.E”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

